



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:139718

Datë: 12.06.2024

Numri i dokumentit: 05816104

C.nr.1/2019

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Besmir Juniku, në çështjen juridike kontestimore të paditësve: A dhe F.K, që të dy nga fshati Pastasel, Komuna e Rahovecit, të cilët me autorizim i përfaqëson Av. Z.Z nga Rahoveci, kundër të paditurës Komuna Rahovec, të cilën me autorizim e përfaqëson Av. B.O nga Rahoveci dhe MBPZHR – Agjencia Pyjore e Kosovës, të cilën e përfaqëson e autorizuar H.S-G, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të vërtetimit të pronësisë, vlera e kontestit 7,500.00 Euro, pas mbajtjes dhe përfundimit të shqyrtimit kryesor të datës 30.05.2024 në prezencën e palëve ndërgjyqëse, ndërsa me datë **12.06.2024** merr këtë:

A K T G J Y K I M

I.REFUZOHET në tërësi si e pabazuar kërkesëpadia e paditësve A dhe F.K, që të dy nga fshati Pastasel, Komuna e Rahovecit, me të cilën kanë kërkuar që të vërtetohet se paditësit janë pronarë - bashkëpronarë të parcelës numër 886-0, vendi i quajtur "Glucak - Dubacak", me kulturë bujqësore, kullosë e klasës IV, me sipërfaqe prej 3193 m², Zona Kadastrale Polluzhë, e cila kufizohet në anën verilindore pika zero, në anën juglindore me parcelën numër 1193-0, në gjatësi prej 67.97m + 29.41m + 58.18m, në gjatësi të përgjithshme prej 155.55m, në anën jugperëndimore me parcelën numër 887-0, në gjatësi prej 29.80m dhe në anën veriperëndimore me parcelën numër 1191-0, në gjatësi prej 39.70m + 42.87m + 25.79m + 32.47m, e në gjatësi të përgjithshme prej 140.83m dhe të detyrohen të paditurat Komuna e Rahovec dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia Pyjore e Kosovës që këtë të drejtë ta pranojnë dhe lejojnë që kjo e drejtë të regjistrohet në librat kadastralë të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Rahovec, e gjithë kjo në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë, si dhe shpenzimet gjyqësore në shumën prej 749.00Euro.

II.Secila nga palët ndërgjyqëse bartë shpenzimet e veta gjyqësore.

A r s y e t i m

Paditësit A dhe F.K, që të dy nga fshati Pastasel, Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson Av. Z.Z nga Rahoveci, në këtë gjykatë me datë 10.08.2016 kanë parashtruar padi kundër të paditurave Komuna e Rahovecit dhe MBPZHR – Agjencia Pyjore e Kosovës, të cilën e përfaqëson H.S-G, për shkak të vërtetimit të pronësisë në bazë të parashkrimit fitues. Kjo

gjykatë e ka ndërprerë procedurën sipas Aktvendimit C.nr.276/2016 të datës 05.10.2017, ndërsa pala paditëse ka kërkuar vazhdimin e procedurës me parashtrësën e datës 04.01.2019.

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësit përmes të autorizuarit të tyre, Av. Z.Z, në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare kanë theksuar se: paditësit A.K dhe Flurim Krasniqi, janë në posedim dhe shfrytëzim të pandërprerë të parcelës kadastrale nr. 886-0, në vendin e quajtur “Glluqak-Dubiqak”, në sipërfaqe prej 3193 m², në ZK Polluzhë. Para tyre, deri sa ka qenë gjallë edhe i ati i tyre (R E.K) e ka mbajtur dhe punuar këtë parcelë. Gjyshi i paditësve E.K, këtë parcelë dhe parcelat 887 dhe 888-0 në vitin 1971 i ka blerë prej S.A.K nga fshati Pastaselë. Këto tri parcela i ka blerë babagjyshi E prej S.A.K nga fshati Pastasellë në vitin 1971 dhe prej atij viti, e deri më sot familja e paditësve e ka pas poseduar dhe punuar këtë patundshmëri, duke e mbjellë me grurë dhe misër, si dhe kultura të tjera bujqësore. Për mbajtjen dhe shfrytëzimin e kësaj patundshmërie paditësit dhe të parët e tyre nga askush nuk kanë pasur ndonjë pengesë apo kundërshtim. Sipas Historiatit të Drejtorisë për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë, të komunës, të datës 05.07.2016, parcela kontestuese ka qenë me kulturë kullosë e klasës IV dhe e njëjta në vitin 1965 ka qenë regjistruar në Regjistrin ABC të pronarëve, nr. 57, ZK Polluzhë, në emër të S.A.K, të cilën parcelë ky i fundit ia shet gjyshit të paditësve E.K dhe këtë parcelë familja e E.K e ka mbajtur dhe shfrytëzuar qysh nga viti 1971. Paraqitet pyetja se si kjo patundshmëri në të njëjtin vit ka mundur të regjistrohet si pronë shoqërore, kur dihet se të tri këto parcela të lartpërmendura ia ka shitur S.K gjyshit të paditësve E.K. Toka pjellore kurrsesi nuk ka mundur t’i bartet Ekonomisë së Pyjeve, sepse ajo me kulturë nuk ka qenë pyll. Sipas certifikatës mbi historiatin deri në vitin 1965 parcela objekt kontesti ka qenë i regjistruar në pronësi të S.A.K dhe në të njëjtin vit për shkaqe të panjohura bartet në pronë shoqërore, në ndërmarrjen për shfrytëzimin e pyjeve Koretnik në Prizren, e që tani është në kuadër të Agjencisë Pyjore të Kosovës, ndërsa dy parcelat tjera që kanë qenë pjesë integrale e parcelës nr. 887 dhe nr. 888 mbesin në pronësi private të evidentuara në emër të Agim Krasniqit. Për këtë bartje në pronën shoqërore të parcelës kontestuese nuk ekziston asnjë vendim i formës së prerë i organeve përkatëse. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e paditësve ta aprovojë në tërësi si të bazuar dhe të vërtetohet se paditësit janë pronarë - bashkëpronarë të parcelës numër 886-0, vendi i quajtur “Glucak - Dubacak”, me kulturë bujqësore, kullosë e klasës IV, me sipërfaqe prej 3193 m², Zona Kadastrale Polluzhë, me kufizimet si në ekspertizë dhe të detyrohen të paditurat Komuna e Rahovec dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural – Agjencia Pyjore e Kosovës që këtë të drejtë ta pranojnë dhe lejojnë që kjo e drejtë të regjistrohet në librat kadastralë të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Rahovec, e gjithë kjo në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë, si dhe shpenzimet gjyqësore në shumën prej 749.00€uro.

I autorizuari i të paditurës Av. B.O, në përgjigje në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se: e kontestojmë kërkesëpadinë e paditësve në tërësi si të pabazuar. Në bazë të certifikatës së pronave, në shkresat e lëndës, vërtetohet se paluajtshmëria kontestuese, njësia kadastrale nr. 886-0 ZK Polluzhë evidentohet në emër të Pronë Shtetërore e Kosovës KK Rahovec, shfrytëzues Ekonomia e Pyjeve e Kosovës, e që sot emërtohet si Agjencioni Pyjor i Kosovës. Gjithashtu, në bazë të historiatit të parcelës, në shkresat e lëndës, vërtetohet fakti i pakontestueshëm se parcela kontestuese që nga viti 1959 dhe me ekspozimin e të dhënave nga ana e komisionit të atëhershëm nga viti 1965, kjo parcelë ka kaluar në emër të pronës shtetërore. Që nga ajo kohë deri në parashtrimin e padisë në gjykatë, nga ana e

paditësve, kanë kaluar mbi 40 vjet dhe se këtu kemi të bëjmë me pronë në shfrytëzim të Agjencionit Pyjor të Kosovës, që rregullohet me Ligjin për Pyjet të Kosovës, me të cilin është rregulluar se vërtetimi i pronësisë me mbajtje, me mirëbesim, nuk mund të kalohet pronësia nga prona shtetërore në atë private. Gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

E paditura MBPZHR – Agjencia Pyjore e Kosovës, përmes të autorizuarës H.S-G në përgjigje në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar: e kundërshtojmë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve. Paditësit, me asnjë provë materiale nuk kanë mundur të vërtetojnë atë të cilën e kërkojnë përmes padisë dhe kërkesëpadisë. Në mbështetje të Ligjit për Pyjet të Kosovës, me pyje dhe toka pyjore menaxhon dhe administron Agjencia Pyjore e Kosovës, andaj në rastin konkret, këtu është e qartë se kush është pronari i kësaj parcele kontestuese, andaj në rastin konkret nuk kemi të bëjmë fare me tokë private, ashtu siç pretendojnë paditësit. Sipas certifikatës së pronës, parcela evidentohet në emër të Pronë Shoqërore e Kosovës, shfrytëzues Ekonomia e Pyjeve Rahovec, tani Agjencia Pyjore e Kosovës. Në bazë të Ligjit për Pyjet të Kosovës theksohet se asnjë person nuk mund të fitojë përmes posedimit të drejtën e pronësisë, andaj i propozojmë gjykatës që ta refuzojë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar. Pas administrimit të provave në tërësi u vetëtuar se paditësit nuk kanë mundur të argumentojnë të drejtën e tyre të kërkuar përmes padisë me arsyetim se nga certifikata e pronës si dhe nga ekspertiza e ekspertit gjeodet parcela kadastrale kontestuese evidentohet në emër të Pasuri Shtetërore e Kosovës, KK Rahovec, shfrytëzues Ekonomia e Pyjeve Rahovec, me të cilën parcelë menaxhon dhe administron e paditura e dytë Agjencia Pyjore e Kosovës, krejt kjo sipas Ligjit për Pyjet e Kosovës. Në mbështetje të nenit 11.4 të Ligjit për Pyjet e Kosovës nr. 08/L-137 ku në këtë nen përcaktohet se asnjë person nuk mund të fitoj pronësinë përmes parashkrimit fitues. Po ashtu të gjitha ligjet që kanë në fuqi më herët në mënyrë kronologjike e kanë ndaluar fitimin e pronësisë përmes parashkrimit fitues. I autorizuari i paditësve deklaroi se këtu paditësit e shfrytëzojnë parcelën kontestuese mirëpo me rastin e daljes në teren së bashku me ekspertin e gjeodezisë është kontestuar se nuk është duke u shfrytëzuar nga askush, mirëpo edhe në rast se shfrytëzohet nga ana e të njëjtëve kjo është uzurpim. E paditura e dytë e ka fituar të drejtën e pronësisë përmes regjistrimit në regjistrat kadastral sipas 33 të LMTHJP-ës, andaj e paditura e dytë kërkon nga gjykata që ta refuzon në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve si të pabazuar.

Gjykata ka lejuar ndryshimin e kërkesëpadisë rritjen e vlerës konform nenit 257 të LPK-së.

Gjykata ka angazhuar ekspertin e gjeodezisë A.M nga Rahoveci, ka dalë në vend së bashku me palët ndërgjyqëse. Ekspertizën e gjeodezisë e ka proceduar te palët ndërgjyqëse.

Gjendja faktike e vërtetuar.

Për të vërtetuar faktet vendimtare në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata i ka administruar këto prova:

1. Dheshmi vdekje në emër të R.Ke datës data..., e lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Drenoc.
2. Skica tereni e datës 05.08.2016, e përpiluar nga Sakip Shala.
3. Certifikatë e paluajtshmërisë nr. 08-4042 e datës 04.08.2016, lëshuar nga ZK Rahovec.
4. Historiati e parcelës i datës 05.07.2016, i lëshuar nga Drejtoria për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë KK Rahovec.
5. Ekspertizë e gjeodezisë e datës 25.04.2024, të përpiluar nga eksperti A.M nga Rahoveci.

Po ashtu, është bërë dëgjimi i dëshmitarëve: A.K dhe A1.K, që të dy nga fshati Pastasel, Komuna e Rahovecit, si dhe në cilësi të palës janë dëgjuar paditësit A2.K dhe F.K.

Dëshmitari A.K, në dëshminë e tij të dhënë në shqyrtimin kryesor të datës 30.05.2024, ka deklaruar se: kjo parcelë ndodhet në rrugën për fshatin Polluzhë. Unë paditësit i kam bashkëfshatarë dhe e di se atë parcelë e ka punuar dhe ka qenë në pronësi të Rasim Etemit, të cilin paditësit e kanë pas babë. Unë shumë mirë e di se këtë parcelë e kanë mbjellë me bostan, shumë kohë edhe grurë dhe këtë e ka bërë babai i paditësve R. Para Rt pronari i kësaj parcele ka qenë S.A. Deri rreth viteve 1970 unë e di se pronar ka qenë S.A, ndërsa rreth vitit 1972 këtë pronë e ka blerë R.E babai i paditësve. Meqenëse unë e kam pas shok R.E i njëjti më ka treguar se parcelën e përmendur më lartë e ka blerë nga S.A në vitin 1972, dhe ja ka paguar të hollat për këtë shitblerje, dhe sa ka paguar nuk e di. Unë nuk kam parë ndonjë kontratë me shkrim apo ndonjë certifikatë të parcelës dhe as nuk kam qenë prezent kur është bërë shitblerja dhe janë dhënë të hollat, por këto informata i kam nga i ndjeri Rasim, të cilin e kisha shok. Kjo parcelë gjithmonë ka qenë e punueshme nga R si dhe djemtë e tij, të cilët e punojnë edhe ditën e sotme, e që kohët e fundit është mbjellë me kunguj. Paditësit kanë edhe parcela tjera ngjitur me këtë parcelë e që edhe ato i punojnë.

Dëshmitari A1.K, në dëshminë e tij të dhënë në shqyrtimin kryesor të datës 30.05.2024, ka deklaruar se: kjo parcelë e di se ku ndodhet, përkatësisht ndodhet në fund të fshatit Pastasel, rruga e Polluzhës. Unë e di se pronari i kësaj parcele ka qenë babai i paditësve R.K, i cili prej vitit 1975 e tutje e ka shfrytëzuar dhe ka punuar parcelën të cilën tani e kanë vazhduar edhe vetë paditësit. Ashtu siç kam dëgjuar në fshat pronar para viteve 70-ta, ka qenë S.K, i cili e ka shitur tek babai i paditësve. Ajo tokë rregullisht është punuar nga prindi i paditësve dhe deri më sot nga vetë paditësit. Nuk kam njohuri nëse janë penguar nga dikush.

Paditësi A.K(i dëgjuar në cilësinë e palës), në dëshminë e tij të dhënë në shqyrtimin kryesor të datës 30.05.2024 ka deklaruar se: historiku i kësaj parcele është se qysh në kohën kur unë kam qenë fëmijë kjo parcelë është blerë nga babëgjyshi im E.H.K prej S.K, i cili i ka dhënë të hollat, e që kjo shitblerja ka ndodhur rreth vitit 1971, nga ai vit babai im R dhe më tutje ne si pasardhës kemi hyrë në posedim dhe kemi shfrytëzuar parcelën, e kemi punuar dhe e kemi mbjellë me kultura të ndryshme. Shitblerja ka ndodhur ndërmjet S.K t dhe E.K, e që kush ka qenë prezent në momentin e shitblerjes tani mund të jenë të vdekur. Para 8 viteve, pra edhe kur kam ushtruar padinë e kam kuptuar se parcela në fjalë nuk është në emër të babëgjyshit tim dhe këtë e kam kuptuar në atë kohë kur unë kam shkuar në kadastër me qëllim të rregullimit të tokave në emër të gjyshit dhe babait tim, pasi kam biseduar me pasardhësit e S.K t, me qëllim të rregullimit të pronësisë edhe në kadastër. Kam nxjerr certifikatën dhe e kam parë aty se parcela evidentohet në emër të Komunës së Rahovecit. Pasi kam vërejte këtë edhe kam ushtruar padi. Këtë parcelë paraardhësit tanë dhe ne e kemi në posedim, e kemi shfrytëzuar gjatë gjithë kohës

dhe e shfrytëzojmë prapë, dhe për këtë nuk na ka penguar askush, për shkak se kjo është tokë e jona. Kjo tokë gjithmonë ka qenë tokë e punueshme dhe asnjëherë nuk ka qenë mal. Po ashtu njoftoj gjykatën se shitblerja e përmendur më lartë nuk është bërë me ndonjë kontratë me shkrim për shkak se në atë kohë shitblerjet janë bërë në mirëbesim.

Paditësi F.K(i dëgjuar në cilësinë e palës), në dëshminë e tij të dhënë në shqyrtimin kryesor të datës 30.05.2024 ka deklaruar se: ashtu siç deklaroi vëllai im kjo parcelë është blerë nga S.K, në vitin 1971, nga babëgjyshi im dhe në atë parcelë familja ime ka hyrë në posedim, e kemi shfrytëzuar dhe e mbajmë me mirëbesim nga viti 1971 e deri më sot. Aty i kemi edhe parcelat tjera të cilat i punojmë, e po ashtu e punojmë edhe këtë parcelë dhe nuk kemi pengesa nga askush. Kjo parcelë gjithmonë ka qenë tokë e punueshme dhe asnjëherë nuk ka qenë mal.

Me analizimin dhe shikimin në provat: Ekspertizë e gjeodezisë me historiat të datës 25.04.2024 (data e pranimit në gjykatë) e përpiluar nga eksperti A.M nga Rahoveci dhe sqarimet në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 30.05.2024; (të cilës gjykata ia dha besimin e plotë) vërtetoi faktin se parcela objekt kontesti numër 886-0 ZK Polluzhë, me sipërfaqe 3193m², me kufizimet si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në vitin 1965 me incizimin aerofotogrametrik dhe ekspozimit e të dhënave në shikim publik të qytetarëve është regjistruar në Regjistrin ABC të pronarëve nr.57 në emër të S.A.K. Nga kjo nënkupton se regjistrimi në emër të pronarit S.A.K është kryer në bazë të vendimit të Komisionit, duke u bazuar në incizimin nga aeroplani dhe komunikimit me qytetarët në terren. Në vitin 1965, një Komision tjetër ka shqyrtuar të dhënat dhe parcelën kontestuese e çregjistron nga emri i pronarit S.A.K dhe e bartë në regjistrin nr. ABC nr. 43, në emër të Pronë Shoqërore - Ndërmarrja për Shfrytëzimin e pyjeve “Koretник” Prizren. Në vitin 1967 hynë në fuqi kadastrin e ri teknik i përpiluar me të dhënat e riveimit aerofotogrametrik, ekspozimit të të dhënave në shikim publik të qytetarëve gjatë vitit 1965, kështu që me hyrjen në fuqi të kadastrit të ri teknik matës parcela kontestuese regjistrohet - evidentohet në fletën poseduese nr. 43, në emër të pronë shoqërore Ndërmarrja për Shfrytëzimin e Pyjeve “Koretник” Prizren. Në vitin 1999 me dekretligjin për shpalljen e pronë shoqërore titullari ndryshohet, nga Pronë Shoqërore Ndërmarrja për Shfrytëzimin e Pyjeve “Koretник” Prizren, regjistrohet në pasuri shtetërore K.K. Rahovec, me shfrytëzues Ekonomia e Pyjeve - Rahovec. Sipas gjendjes së fundit në elaboratin kadastral, parcela kontestuese edhe sot evidentohet në emër të Pasuri Shtetërore e Kosovës K.K. Rahovec, shfrytëzues Ekonomia e Pyjeve. Në rastin e identifikimit të parcelës kontestuese në vend është shfrytëzuar metoda e identifikimit dhe duke u bazuar në ortofoto është konstatuar se për nga lloji i shfrytëzimit aktual në vend përdoret si tokë bujqësore me kulturë arë, mirëpo e lënë djerrinë, e pa punuar. Ekspertiza e gjeodezisë është profesionale dhe e besueshme për gjykatën, për shkak se përputhet edhe me provat tjera dhe shikimin në vend nga gjykata, si dhe është sqaruar në mënyrë të qartë nga eksperti në seancën e shqyrtimit kryesor.

Gjykata me dëgjimin e dëshmitarëve dhe paditësve (të cilëve ua dha besimin pjesërisht) vërtetoi faktin se parcela objekt kontesti është shfrytëzuar nga paraardhësi i paditësve R.K dhe vetë paditësit dhe atë nga viti 1971. Në këtë pjesë dëshmitë e dëshmitarëve dhe paditësve janë në përputhje me njëra tjetrën dhe provat në shkresat e lëndës dhe si të tilla edhe për gjykatën janë të besueshme, sa i përket shfrytëzimit të parcelës objekt kontesti. Pjesa tjetër e deklaramit të paditësve lidhur me atë se paraardhësi i paditësve Etem Krasniqi në vitin 1971-1975 e ka blerë parcelën nga Sejdi Ali Krasniqi, nuk e merr besimin e gjykatës, me arsyetimin se dëshmia e tyre bie ndesh me dëshminë e dëshmitarëve dhe provat në shkresat e lëndës, përkatësisht me ekspertizën e gjeodezisë dhe historiatin e parcelës, nga e cila është vërtetuar se në vitin 1971-1975 parcela objekt kontesti nuk ka qenë fare në pronësi të S.K t dhe shitblerja nuk ka mundur të realizohet nga personi që nuk është pronar. Po ashtu dëshmitarët kanë deklaruar se parcela

është blerë nga R.K, ndërsa paditësit kanë deklaruar se parcela është blerë nga Etem Krasniqi, deklarime që bien ndesh njëra me tjetrën.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës.

Gjykata pas vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, analizimit të provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, duke ardh në përfundim se: **kërkesëpadia e paditësve është e pabazuar dhe si e tillë duhet të refuzohet.**

Ligji i Punës së Bashkuar (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 53/76), me plotësimet dhe ndryshimet e tij sipas ligjeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 57/83 dhe nr. 85/87), të cilët kanë qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik- transferimit të pronësisë së parcelës kontestuese, në nenin 226 e përcakton se *”Në qoftë se patundshmëria përkatëse eventualisht kalon në pronësi shoqërore pa ndonjë bazë të vlefshme juridike, pronari e humb të drejtën e pronësisë, në qoftë se nuk e kërkon kthimin e kësaj pronësie në afatin prej 5 vitesh nga data e marrjes në dijeni për këtë fakt, e më së largu në afat prej 10 vitesh”.*

Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike – Pronësore (LMTHJP) i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raporteve juridike lidhur me këtë çështje kontestimore, në nenin 20 e përcakton se *”E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim. E drejta e pronësisë fitohet edhe në bazë të vendimit të organit shtetëror në kushtet dhe në mënyrën e caktuar me ligj”.* Ndërsa neni 33 e përcakton *” Në bazë të veprimit juridik e drejta e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme fitohet me regjistrimin në librin publik ose në mënyrën tjetër përkatëse të caktuar me ligj”,* neni 21 i të njëjtit ligj e përcakton se *”Sipas vetë ligjit e drejta e pronësisë fitohet me krijimin e sendit të ri, me bashkim, me përzierje, me ndërtim në tokën e huaj, me ndarjen e fryteve, me parashkrimin fitues, me fitim të pronësisë nga jo-pronari, me okupim dhe në raste të tjera të caktuara me ligj, ndërsa fitimi i të drejtës së pronësisë në bazë të trashëgimisë rregullohet me nenin 36 të të njëjtit ligj, ku përcaktohet se ”E drejta e pronësisë mbi sendin fitohet me anë të trashëgimit në momentin e hapjes së trashëgimisë në pasurinë e të vdekurit, po qe se me ligj nuk është caktuar ndryshe” dhe neni 29 e përcakton se ”Mbi sendin në pronësinë shoqërore e drejta e pronësisë nuk mund të fitohet me parashkrimin fitues”.*

Ligji për Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme (Gazeta Zyrtare KSAK nr.45/81, 29/86, 28/88) i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raportit juridik- transferimit të pronës objekt kontesti, në nenin 10 e përcakton se në raste të tilla kur prona kalon nga pronësia private, në atë shoqërore me vendim, atëherë pronari mund ta atakon vendimin në procedurë administrative dhe të vazhdoj kontestin në gjykatën kompetente administrative. Historiati i parcelës e ka shpjeguar se në vitin 1965 me incizimin aerofotogrametrik dhe ekspozimit e të dhënave në shikim publik të qytetarëve parcela objekt kontesti është regjistruar në Regjistrin ABC të pronarëve nr.57 në emër të S.A.K. Nga kjo nënkupton se regjistrimi në emër të pronarit S.A.K është kryer në bazë të vendimit të Komisionit, duke u bazuar në incizimin nga aeroplani dhe komunikimit me qytetarët në terren. Në vitin 1967 përsëri organi shtetëror – komisioni tjetër ka nxjerrë kadastrin e ri teknik matës dhe i njëjti ka hy në fuqi të të njëjtin vit, ku parcela kontestuese regjistrohet - evidentohet në fletën poseduese nr. 43, nga pronari S.K në emër të pronë shoqërore Ndërmarrja për Shfrytëzimin e Pyjeve “Koretник” Prizren. Pronari i atëhershëm S.K ka mundur të zhvilloj procedurë administrative ndaj vendimit të komisionit për transferimin e pronës nga private në shtetërore, mirëpo këtë nuk e ka bërë, pra është pajtuar me vendimin e komisionit. Në vitin 1999 me dekretligjin për shpalljen e pronë shoqërore titullari ndryshohet, nga Pronë Shoqërore

Ndërmarrja për Shfrytëzimin e Pyjeve “Koretnik” Prizren, regjistrohet në pasuri shtetërore K.K. Rahovec, me shfrytëzues Ekonomia e Pyjeve – Rahovec dhe kjo është bazë ligjore e vlefshme sipas të cilës e paditura 1. ka të drejtën e pronësisë në parcelën kontestuese, ndërsa e paditura 2. ka të drejtën e shfrytëzimit.

Sipas bazës ligjore, dispozitave të potencuara gjykata gjeti se kërkesëpadia e paditësve në **është e pabazuar dhe si e tillë është refuzuar në tërësi**, me arsyetimin se pronësia në këtë parcelë është regjistruar sipas vendimit të organit shtetëror dhe ligjit dhe si e tillë është bazë juridike e vlefshme sipas të cilës parcela objekt kontesti evidentohet në pronësi të të paditurës së parë Komuna Rahovec, ndërsa në raport me të paditurën e dytë MBPZHR – Agjencia Pyjore e Kosovës është e pabazuar për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv në procedurë, me arsyetimin se e paditura e dytë është shfrytëzuese e parcelës objekt kontesti dhe nga ajo nuk mund të kërkohet vërtetimi i të drejtës së pronësisë.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, me arsyetimin se nga provat e administruara, gjykata ka vërtetuar faktin se parcela kontestuese në vitin 1965 ka qenë e evidentuar në pronësi të S.A.K, mirëpo kjo ka zgjatur deri në vitin 1967, kur e njëjta me vendim shtetëror kalon në pronësi shoqërore, ndërsa pretendimet e paditësve se në vitin 1971 gjyshi i tyre E.K e ka blerë parcelën nga S.K, bien ndesh me gjendjen faktike të vërtetuar me ekspertizë dhe historiat, ngase në vitin 1971 nuk ka pas mundësi të kryhet shitblerja e parcelës, për shkak se pronar nuk ishte Etem Krasniqi dhe i njëjti nuk kishte tagër që të kryej shitblerje. Në rastet kur kryhet shitblerja të paktën palët do të kërkonin certifikatën e pronësisë, për ta verifikuar se kush është pronari i saj. Prandaj shitblerja e parcelës e përshkruar më lartë me asnjë provë nuk është vërtetuar. Dëshmia e dëshmitarëve ka qenë në shpërputhje me deklaratimet e paditësve, ku dëshmitarët kanë theksuar se parcela është blerë nga R.K (babai i paditësve), ndërsa paditësit pretendojnë se ajo është blerë nga E.K (gjyshi). Në çdo rast kur kemi të bëjmë me shitblerje të paluajtshmërive LMTHJP e rregullon saktë procedurën në nenin 20 dhe 33, sipas këtyre dispozitave ligjore e drejta e pronësisë fitohet edhe me punë juridike, pra me lidhjen e kontratës së shitblerjes në formë të shkruar dhe regjistrimin e saj në librat publikë (regjistrat kadastral), gjë që paraardhësi i paditësve nuk e ka bërë, e që është vërtetuar se në vitin 1971 nuk ka mundur ta bëjë, për shkak se në atë kohë S.K nuk ishte pronar i parcelës.

Nëse ndalemi tek transferimi i pronës që ka ndodhur në vitin 1967 nga Sejdiu tek pasuria shoqërore, ky ndryshim i titullarit është bërë me vendim të organit shtetëror të elaboruar më lartë, konform nenit 20 të LMTHJP-së. Anulimi dhe prishja e këtij vendimi është dashtë të bëhet në procedurë administrative apo gjyqësore sipas Ligji për Qarkullimin e Pasurisë së Paluajtshme (Gazeta Zyrtare KSAK nr.45/81, 29/86, 28/88) dhe Ligjit të Punës së Bashkuar (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 53/76), me plotësimet dhe ndryshimet e tij sipas ligjeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së nr. 57/83 dhe nr. 85/87), dhe atë brenda afatit prej 5 viteve nga data e marrjes në dijeni për transferimin e pronës së paluajtshmërisë në pronësi shoqërore, e më së largu në afat prej 10 vitesh nga momenti i transferimit, për çka rezulton se pronari S.K nuk e ka respektuar këtë afat, përkatësisht fare nuk është marrë me këtë çështje. Prandaj nga kjo rezulton se paditësit nuk kanë mundur ta fitojnë pronësinë me parashkrim fitues, ngase kjo mënyrë e fitimit të pronësisë në paluajtshmërinë në pronësi shoqërore ka qenë e ndaluar sipas nenit 29 të LMTHJP-së edhe pse gjykata e ka vërtetuar se paraardhësit e paditësve dhe vetë paditësit kanë qenë posedues me keqbesim të parcelës objekt kontesti, për shkak se Etem dhe R.K nuk kanë ndonjë bazë juridike nga e cila do të ju krijohej mirëbesimi në mbajtjen e parcelës dhe nga kjo rezulton se e kanë ditur se janë duke poseduar parcelë në pronësi shoqërore. Mbajtja me keqbesim nga paraardhësi, konsiderohet si keqbesim edhe tek pasardhësit e tij, pra deri tek paditësit. Po ashtu nëse i referohemi fitimit të pronësisë sipas trashëgimisë, prapë nuk kanë bazë, pasi që në rastin konkret

parcela evidentohet në pronësi të Kuvendi Komunal Rahovec, pra nuk vie në shprehje fitimi i të drejtës së pronësisë në bazë të trashëgimisë, për shkak se parcela objekt kontesti nuk është regjistruar në librat publik në emër të paraardhësit të paditësve, këtu të ndjerit R.K, nuk është vërtetuar se është pasuri e tij dhe si e tillë nuk mund të trashëgohet, ashtu që nuk plotësohen kushtet që përcaktohen me nenin 36 i LMTHJP-së.

Nga të gjitha të lartcekurat, rrjedh se nuk ekziston asnjë bazë ligjore mbi të cilën paditësit do të mund të kishin fituar të drejtën e pronësisë mbi paluajtshmërinë kontestuese. Të qenit pronë shoqërore e bën këtë paluajtshmëri një send me një trajtim ligjor më të veçantë në të cilin për t'u fituar e drejta e pronësisë duhet të plotësohen kushtet ligjore në mënyrë kumulative - mirëbesimin në posedim dhe shfrytëzim të parcelës dhe kalimin e kohës- afatit ligjor. Kështu, në mungesë të bazës ligjore apo të veprimit juridik të vlefshëm për fitimin e të drejtës së pronësisë, nuk janë plotësuar kushtet e përcaktuara nga neni 20 i LMTHJP-së për fitimin e një të drejte të tillë. Pretendimet e palës paditëse se mirëbesimi është krijuar mbi bazën e shitblerjes së parcelës nga S.K nuk qëndrojnë, ngase gjykata nuk ka mundur ta vërtetoj shitblerjen, për shkak se në vitin 1971 S.K nuk ishte pronar i parcelës dhe nuk ka mundur ta shes atë. Në këtë rast vlen parimi se pala nuk mund të bartë më shumë të drejta se sa që i ka.

Nëse i referohemi shfuqizimit të nenit 29 të LMTHJP-së në vitin 1996, rezulton se edhe pas vitit 1996 poseduesit, këtu paraardhësit dhe vetë paditësit e kanë mbajtur parcelën me keqbesim. Me asnjë provë pala paditëse nuk e ka argumentuar se pronën e ka mbajtur me mirëbesim.

Pretendimet e të autorizuarit të paditësit se parcela objekt kontesti pa kurrfarë baze juridike ka kaluar në pronësi të të paditurave nuk qëndron, me arsyetimin se nga provat e administruara parcela objekt kontesti sipas vendimit të organit shtetëror në vitin 1967 bën transferimin e titullarit të pronësisë së parcelës në pronësi shoqërore "Ndërmarrja për shfrytëzimin e pyjeve "Koritnik – Rahovec" dhe kjo konsiderohet si bazë juridike e vlefshme – vendim i organit shtetëror, të përcaktuar sipas nenit 20 të LMTHJP-së. A kanë qenë ky vendim i ligjshëm, kjo gjykatë nuk mund ta vlerësoj, për shkak se S.K ka pas afatet kur ka mundur ta atakoj vendimin në fjalë dhe atë në procedurë administrative dhe gjyqësore, mirëpo nuk i ka shfrytëzuar të drejtat e tij brenda afateve ligjore sipas dispozitave ligjore në fuqi në atë kohë, andaj vendimi ka mbet në fuqi dhe si i tillë përbën bazë juridike të vlefshme për fitimin e pronësisë në parcelën objekt kontesti nga këtu e paditura e parë.

Pretendimet e të autorizuarit i të paditurës së parë av. Bilbil Oruqi se palës paditëse i mungon legjitimiteti aktiv në procedurë, me arsyetimin se dëshmivdekjet nuk janë prova të mjaftueshme për të argumentuar se paditësit kanë legjitimitet aktiv në procedurë nuk qëndrojnë, për faktin se dëshmivdekjet janë prova të besueshme dhe dokumente publike, të cilave gjykata ua ka dhënë besimin dhe nga të cilat ka vërtetuar se pasardhës ligjor pas të ndjerit R.K janë paditësit, të cilët kanë legjitimitet të plotë aktiv në procedurë.

Gjykata ka analizuar edhe provat tjera dhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, mirëpo të njëjtat nuk kanë impakt në vendosjen ndryshe nga dispozitivi i këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale, gjykata e mbështeti në harmoni me 463.1 të LPK-së.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 142 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
C.nr.1/2019, datë 12.06.2024

Gj y q t a r i
Besmir JUNIKU

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit. Ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë – Divizionit Civil.